



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 09
Prishtinë, më 22 prill 2011

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 22 PRILL 2011**

Mbledhjen e drejtoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri HAMITI**, nënkryetar Kuvendit.

Kryesuesi deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 75 deputetë. Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 31 mars dhe 7 prill 2011,
4. Formimi i Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës,
5. Zgjedhja e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave, për vitin 2010,

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, për vitin 2010,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2010,
9. Shqyrtimi i Raportit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për periudhën mars 2009 - dhjetor 2010,
10. Shqyrtimi i Propozimit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese,
11. Shqyrtimi i Propozim - Programit të punës së Kuvendit për vitin 2011, dhe
12. Propozimi i Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Bekim Haxhiu, në emër të GP PDK, Afërdita Berisha – Shaqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myfera Shinik, Fadil Demaku, Imri Ahmeti, Alma Lama, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Burim Ramadani, Halit Krasniqi, Adem Grabovci, si dhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi. Diskutimet e plota janë dhënë në Transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Time Kadrijaj**, parashtoi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi lidhur me masat që po ndërmerret Qeveria e Kosovës për kontrollin e pikave doganore 1 dhe 31.

Ministri Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetes Kadrijaj.

Deputeti **Bali Muharremi**, parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me mos reagimin e Qeverisë për burgosjen e Blerim Kuçit, Kryetarit të Komunës së Suharekës.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Muharremi.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura me 31 mars dhe 7 prill 2011

Kuvendi miratoi, pa vërejtje, procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit, të mbajtura më 31 mars dhe 7 prill 2011.

4. Formimi i Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Ligjit për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se kryetarët e grupeve parlamentare, duke u bazuar në pikën 1 dhe 2 të Rezolutës në mbështetje të Memorandumit të Marrëveshjes ndërmjet PDK-së, LDK-së dhe AKR-së, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 7 prill 2011, i propozojnë seancës plenare krijimin e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të Komisionit për amendamentimin e Ligjit për zgjedhje të përgjithshme.

Ismet Beqiri, në emër të propozuesit paraqiti arsyeshmërinë e këtij propozimi, të cilin e vlerësoi të rëndësishëm për të ardhmen e legjislacionit në Republikën e Kosovës. Ai ftoi deputetët për miratim të këtij propozimi.

Adem Grabovci, në emër të GP PDK-së, tha se pajtohet plotësisht me propozimin për formimin e këtyre dy komisioneve. Ai në emër të GP PDK-së propozoi që në Komisionin për amendamentimin e Ligjit për zgjedhje të përgjithshme, deputeti Behar Selimi të zëvendësohet me deputetin dhe nënkryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, ndërsa në Komisionin parlamentar për Legjislacion propozoi që deputeti Arsim Bajrami të zëvendësohet me deputetin Behar Selimi, i cili propozohet për zëvendëskryetar të parë të këtij komisioni.

Visar Ymeri, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje” tha se do të marrim pjesë në këto dy komisione, por nuk pajtohem me mënyrën e propozuar për formimin e këtyre komisioneve.

Donika Kadaj – Bujupi, në emër të GP AAK-së, tha se pajtohet me propozimin për formimin e këtyre komisioneve. Ajo shtoi se në këto komisione duhet të përfaqësohet edhe struktura gjinore.

Ibrahim Makolli, në emër të Koalicionit Kosova e Re, tha se do të përkrahim formimin e këtyre komisioneve.

Kryesuesi hodhi në votim krijimin e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të legjislacionit të ndërlidhur në mënyrë që presidenti i Republikës së Kosovës të zgjedhet drejtpërdrejt nga populli, si dhe të Komisionit për amendamentimin e Ligjit për zgjedhje të përgjithshme.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 76,
Kundër----- 6,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës

I. Formohet Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të legjislacionit të ndërlidhur, në mënyrë që Presidenti i Republikës së Kosovës të zgjedhet drejtpërdrejt nga populli, në këtë përbërje:

1. Arsim Bajrami, GP-PDK, kryesues,
2. Hydajet Hyseni-Kaloshi, GP-PDK, anëtar,
3. Vjosa Osmani, GP LDK, anëtare,
4. Arben Gashi, GP LDK, anëtar,
5. Afrim Kasolli, GP “Vetëvendosje”, anëtar,
6. Ardian Gjini, GP-AAK, anëtar,

7. Ibrahim Makolli, GP KKR, anëtar,
8. Saša Milosavljević, GP SLS, anëtar,
9. Rasim Demiri, GP “6 +”, anëtar.

II. Komisioni i formuar nga pika **I.** e këtij Vendimi kryen punën e vet brenda afatit kohor 6–9 muajsh, nga data e themelimit.

Gjithashtu, Kuvendi mori edhe këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për amendamentimin e Ligjit për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës

I. Formohet Komisioni për amendamentimin e Ligjit për zgjedhje të përgjithshme dhe të legjislacionit të ndërlidhur, në këtë përbërje:

1. Haki Demolli, GP LDK, kryesues,
2. Imri Ahmeti, GP LDK, anëtar,
3. Xhavit Haliti, GP PDK, anëtar,
4. Halit Krasniqi, GP PDK, anëtar,
5. Albulena Haxhiu, GP “Vetëvendosje”, anëtare,
6. Blerim Shala, GP AAK, anëtar,
7. Amir Ahmeti, GP KKR, anëtar,
8. Jasmina Živković, GP SLS, anëtar,
9. Enis Kervan, GP “6 +”, anëtar.

II. Komisioni i formuar nga pika **I.** e këtij Vendimi kryen punën e vet në afatin kohor brenda 8 –12 muajsh, nga data e themelimit.

5. Zgjedhja e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Deputetja **Safete Hadergjonaj**, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, paraqiti arsyetimin e Raportit për përzgjedhjen e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Ajo tha se dy kandidatët e propozuar nga paneli i Bordit të Bankës Qendrore, Gani Gërguri dhe Safet Merovci i plotësojnë kriteret formalo-juridike të parapara në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, për t’u zgjedhur guvernator. Më tej, deputetja Hadergjonaj i rekomandoi Kuvendit që të përzgjedh njërin prej dy kandidatëve të lartpërmendur për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e përzgjedhjes së kandidatëve për guvernator të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Rashiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Rasim Demiri, si dhe deputetët: Nait Hasani dhe Sabri Hamiti, që janë dhënë në transkript.

Kryesuesi, në vazhdim tha se pasi që janë të propozuar dy kandidatë për pozitën e guvernatorit, ndërsa me ligj nuk është përcaktuar mënyra dhe forma e përzgjedhjes, propozoj që votimi të jetë i fshehtë.

Kuvendi votoi për formën e votimit të fshehtë për përzgjedhjen e guvernatorit. Rezultati i votimit ishte:

Për..... 59 vota,
Kundër.... ..5 vota,
Abstenim.... 1 votë.

Kryesuesi konstatoi se votimi për përzgjedhjen e guvernatorit do të jetë i fshehtë.

Më pas, kryesuesi tha se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës, dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë nga një anëtarë për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Ramiz Lladrovci,
2. GP LDK - Hashim Deshishku,
3. GP “Vetëvendosje” – Alma Lama,
4. GP AAK - Bali Muharremaj,
5. GP Koalicioni Kosova e Re – Sevdije Lama,
6. GP SLS – Goran Maksimoviq,
7. GP “6+” - Albert Kinolli.

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, Raportin e paraqiti Alma Lama. Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 99 deputetë dhe rezultati i votimit është si në vijim:

Për Gani Gërgurin votuan 58 deputetë.
Për Safet Merovcin votuan 15 deputetë.
Të pavlefshme ishin 26 fletëvotime.

Kryesuesi tha se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. **Gani GËRGURI**, zgjedhet guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Vendimi i dërgohet Presidentes së Republikës për miratim dhe emërimin e z. Gani Gërguri në pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
3. Mandati i guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës zgjatet deri më 26 mars 2013.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave, për vitin 2010

Deputeti **Idriz Vehapi**, në emër të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin e punës së Komisionit të Pavarur të Mediave, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai, në fund përkrahu Raportin të punës së Komisionit të Pavarur të Mediave, për vitin 2010.

Deputetja **Safete Hadergjonaj**, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, paraqiti arsyetimin e Raportit financiar të Komisionit të Pavarur të Mediave, për vitin 2010, dhe tha se kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Komisionit të Pavarur të Mediave, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë deputetët: Lirije Osmani, Teuta Haxhiu, Petar Miletiq, Alma Lama dhe Ali Sadriu, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Komisionit Pavarur të Mediave, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 50,
Kundër----- 8,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Raportin e punës së Komisionit të Pavarur të Mediave, për vitin 2010.

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, për vitin 2010

Deputetja **Safete Hadergjonaj**, në emër të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin e punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, për vitin 2010 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ajo, në fund përkrahu Raportin e punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2010.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, ndërsa në

emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 39,
Kundër-----20,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin e punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2010.

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2010

Deputetja **Safete Hadergjona**j, në emër të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin e punës së Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2010 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ajo, në fund përkrahu Raportin e punës së Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2010.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ali Sadriu, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 34,
Kundër-----23,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin e punës së Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2010.

9. Shqyrtimi i Raportit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën mars 2009 - dhjetor 2010

Deputeti **Idriz Vehapi**, në emër të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin e punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën mars 2009 dhjetor 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare me vërejtjet e paraqitura nga ana e komisionit.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën mars 2009 - dhjetor 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sali Morina, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Amir Ahmeti, si dhe deputetët: Bekim Haxhiu, Lirije Kajtazi dhe Lutfi Haziri, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën mars 2009 - dhjetor 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 42,
Kundër----- 14,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin e punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën mars 2009 - dhjetor 2010, me rekomandimet e komisionit funksional.

10. Shqyrtimi i Propozimit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese

Deputetja **Safete Hadergjonaj**, në emër të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, tha se si komision kemi shqyrtuar Propozimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese, nga 0.80% në 0.65%, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ajo, në fund përkrahu Propozimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese, nga 0.80% në 0.65%.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Propozimit e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese, nga 0.80% në 0.65%.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Valbona Dibra, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, ndërsa në emër të Koalicionit Kosova e Re, Ibrahim Makolli, si dhe deputeti Armend Zemaj, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Propozimit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese, nga 0.80% në 0.65%.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 49,
Kundër----- 6,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Propozimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese, nga 0.80% në 0.65%.

11. Shqyrtimi i Propozim - Programit të punës së Kuvendit, për vitin 2011

Kryesuesi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se Programi i punës së Kuvendit për vitin 2011 paraqet dokument bazë të Kuvendit për aktivitetin e organit ligjvënës të Republikës së Kosovës. Ky program është hartuar duke u bazuar në këto dokumente:

- Dokumenti i Qeverisë për Strategjinë legislative, për vitin 2011,
- Planet e punës së komisioneve parlamentare, për vitin 2011,
- Plani i veprimt të Kuvendit, datë 10 dhjetor 2008, dhe
- Plani i veprimt të Kuvendit për integritime evropiane, për vitin 2011.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Propozim - Programit të punës së Kuvendit për vitin 2011.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë deputetët: Sala Berisha – Shala dhe Sabri Hamiti., që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Programit të punës së Kuvendit për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 56,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Programin e punës së Kuvendit, për vitin 2011.

11. Propozimi i Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore

Deputeti **Armend Zemaj**, në emër të Komisionit funksional për Legjislacion, tha se si komision kemi shqyrtuar Propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai, në fund përkrahu Propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e z. Adem Vokshi, anëtar në Komisionin për Kërkesa Pronësore, ndërsa u shpreh se flet edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Propozimit të kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Pasi nuk pati deputetë të tjerë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Propozimit të kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e z. Adem Vokshi, anëtar në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 57,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

- 1. Adem VOKSHI**, emërohet anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore.
- Mandati i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore është një (1) vit.

Në fund, **Kryesuesi** i njoftoi deputetët me propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së, se në Komisionin për Legjislacion, deputeti Arsim Bajrami zëvendësohet me deputetin Behar Selimi, i cili do të jetë zëvendëskryetar i parë i këtij komisioni.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 16:13 minuta.

Nënkryetari i Kuvendit,

Xhavit HALITI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale